<p>1. Anëtarët e KA shkarkohen në rastet si në vijim:</p> <p>1.1. Paaftësisë fizike apo mendore për të ushtruar funksionin e tyre;</p> <p>1.2. Konstatohet se ka konflikt interesi;</p> <p>1.3. Është i dënuar për veprë penale me burgim efektiv;</p> <p>1.4. Keqpërdorim i detyrës zyrtare;</p> <p>1.5. Refuzimi i kryerjes së detyrave të përcaktuara në rregulloren e punës;</p> <p>1.6. Mungon më shumë se dy (2) herë radhazi në mbledhjet e KA pa arsytim të bazuar.</p> <p>2. Procedura e shkarkimit të anëtarit të KA, mund të iniciohet nga Ministri, KSHC ose shumica e anëtarëve të KA.</p> <p>3. Për shkarkimin e anëtarit të KA, AKA formon Komision të përkohshëm me përbërje prej:</p>	<p>1. AC members are discharged in the following cases:</p> <p>1.1. Physical or mental inability to exercise their function;</p> <p>1.2. It is found that there is a conflict of interest;</p> <p>1.3. Is convicted of a criminal offense with effective imprisonment;</p> <p>1.4. Abuse of official duty;</p> <p>1.5. Refusal to perform the duties defined by the work regulation;</p> <p>1.6. Absent more than two (2) times in a row in meetings of the AC without reasonable justification.</p> <p>2. Procedure for discharge of AC members can be initiated by the Minister, SQC or the majority of AC members.</p> <p>3. For the discharge of the AC member, the KAA forms a temporary Commission composed of the:</p>	<p>1. Članovi KA-a biće razrešeni u sledećim slučajevima:</p> <p>1.1. Fizička ili mentalna nesposobnost da vrše svoju funkciju;</p> <p>1.2. Utvrđeno je da postoji sukob interesa;</p> <p>1.3. Kažnjen je za krivično delo efektivnom kaznom zatvora;</p> <p>1.4. Zloupotrebe službenog položaja;</p> <p>1.5. Odbijanje da izvrši dužnosti utvrđene u pravilnik o radu;</p> <p>1.6. Odsustvuje više od dva (2) puta zaredom na sastancima KŽ bez opravdano razloga.</p> <p>2. Procedura za razrešenje članove KŽ može inicirati ministar/ka, DSK-a ili većina članova KŽ-a</p> <p>3. Za razrešenje člana KŽ, AKA formira privremenu komisiju sastavljenu od:</p>

<p>3.1. Përfaqësues nga Ministria, një (1) anëtar;</p> <p>3.2. Përfaqësues nga AKA, një (1) anëtar;</p> <p>3.3. Përfaqësues nga Konferenca e Rektorëve, një (1) anëtar;</p> <p>3.4. Profesor i rregullt nga Fakulteti Juridik- një (1) anëtar;</p> <p>3.5. Përfaqësues i një partneri zhvillimor ndërkombëtar aktiv në fushën e arsimit të lartë në Kosovë, një (1) anëtar.</p> <p>4. Komisioni merr vendim lidhur me propozimin për shkarkimin me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.</p> <p>5. Anëtari i shkarkuar i KA, ka të drejtë ankese sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULL III AKREDITIMI</p> <p style="text-align: center;">Neni 25 Aplikimi për akreditim</p>	<p>3.1. Representative from the Ministry, one (1) member;</p> <p>3.2. Representative from the KAA, one (1) member;</p> <p>3.3. Representative from the Rectors conference, one (1) member;</p> <p>3.4. Regular professor from the Law Faculty - one (1) member;</p> <p>3.5. Representative of an active international development partner in the field of higher education in Kosova, one (1) member;</p> <p>4. The Commission makes a decision regarding the proposal for dismissal by a majority vote of all its members.</p> <p>5. The discharged member of AC has the right to appeal according to the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER II ACCREDITATION</p> <p style="text-align: center;">Article 25 Application for accreditation</p>	<p>3.1. Predstavnik ministarstva, jedan (1) član,</p> <p>3.2. Predstavnici KAA, jedan (1) član,</p> <p>3.3. Predstavnici Rektorske konferencije, jedan (1) član;</p> <p>3.4. Redovan profesor Pravnog fakulteta - jedna (1) član;</p> <p>3.5. Predstavnik jednog međunarodnog aktivnog razvojnog partnera, u oblasti visokog obrazovanja na Kosovu, jedan (1) član;</p> <p>4. Komisija donosi većinskim glasanjem donosi odluku u vezi predloga za razrešavanje</p> <p>5. Razrešeni član za KA ima pravo žalbe u skladu sa važećim zakonom.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE III AKREDITACIJA</p> <p style="text-align: center;">Član 25 Prijava za akreditaciju</p>
--	--	--

<p>1. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë që funksionojnë brenda Republikës së Kosovës dhe ofrojnë programe, përfshirë programet online, që shpijnë tek një diplomë akademike apo një diplomë profesionale, obligohen të aplikojnë për akreditim/validim në AKA.</p> <p>2. Vetëm bartësi i akredituar i arsimit të lartë ka të drejtën për të dhënë grada e diploma të specifikuara në vendimin për akreditim.</p> <p>3. Akreditimi i një IAL mund të kërkohet nga:</p> <p>3.1. Vetë institucioni, ose dy e më shumë institucione vendore e ndërkombëtare të arsimit të lartë;</p> <p>3.2. Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë;</p> <p>3.3. Këshilli Shtetëror i Cilësisë në raste specifike.</p> <p>4. Akreditimi institucional nga AKA, akreditimi i programeve dhe licencimi nga Ministria është parakusht për ofrimin e programeve të studimit dhe ushtrimit të veprimtarisë akademike në arsimin e lartë.</p>	<p>1. All higher education institutions operating within the Republic of Kosovo and that offer programs, including online programs, leading to an academic degree or a professional degree, are required to apply for accreditation / validation in the KAA.</p> <p>2. Only the accredited provider of higher education has the right to award the degrees and diplomas specified in the accreditation decision.</p> <p>3. Accreditation of an HEI may be required by:</p> <p>3.1. The institution itself, or two or more local and international institutions of higher education;</p> <p>3.2. The Ministry responsible for higher education;</p> <p>3.3. State Quality Council in specific cases.</p> <p>4. Institutional accreditation by the KAA, accreditation of programs and licensing by the Ministry is a precondition for the provision of study programs and the exercise of academic activity in higher education.</p>	<p>1. Sve institucije visokog obrazovanja koje funkcionišu u Republici Kosovo i nude programe, uključujući online programe, koji vode ka dobijanju akademske ili profesionalne diplome, obavezne su da podnesu zahtev za akreditaciju / validaciju u KAA.</p> <p>2. Samo akreditovani nosilac visokog obrazovanja ima pravo da dodeljuje stepen i diplome navedene u odluci o akreditaciji.</p> <p>3. Akreditaciju IVO može zahtevati od:</p> <p>3.1. Same institucije, ili dve i više domaće ili međunarodne institucije visokog obrazovanja</p> <p>3.2. Ministarstvo nadležno za visoko obrazovanje;</p> <p>3.3. Državni savet za kvalitet u specifičnim slučajevima.</p> <p>4. Institucionalna akreditacija od strane KAA, akreditacija programa i licenciranje od strane ministarstva je preduslov za pružanje studijskih programa i obavljanje akademske aktivnosti u visokom obrazovanju.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 26 Llojet e akreditimit</p> <p>1. Institucionet e arsimit të lartë konkurrojnë për këto lloje të akreditimit:</p> <p>1.1. Akreditim dhe riakreditim institucional;</p> <p>1.2. Akreditim dhe riakreditim i programit të studimit;</p> <p>1.3. Akreditim dhe riakreditim institucional i degës dhe i programeve të studimit të cilët ofrohen në atë degë;</p> <p>1.4. Akreditim i programeve në distancë dhe i programeve online të studimit;</p> <p>1.5. Njohje e akreditimit valid ndërkombëtar, të akredituara ose të njohura nga agjencitë anëtare të EQAR dhe USDE, përmes një procesi të vlerësimit nga AKA.</p>	<p style="text-align: center;">Article 26 Accreditation types</p> <p>1. Higher education institutions compete for these accreditation types:</p> <p>1.1. Institutional accreditation and re-accreditation;</p> <p>1.2. Accreditation and re-accreditation of the study program;</p> <p>1.3. Institutional accreditation and re-accreditation of the branch and of the study programs that are offered in that branch;</p> <p>1.4. Accreditation of distance programs and online study programs;</p> <p>1.5. Recognition of valid international accreditation, accredited or recognized by member agencies of EQAR and USDE, through an evaluation process by KAA;</p>	<p style="text-align: center;">Član 26 Vrste akreditacije</p> <p>1. Institucije visokog obrazovanja konkurišu za ovu vrstu akreditacije:</p> <p>1.1. Institucionalna akreditacija i re-akreditacija;</p> <p>1.2. Akreditacija i re-akreditacija studijskog programa;</p> <p>1.3. Institucionalna Akreditacija i re-akreditacija smera i studijskih programa koji se nude na tom smeru;</p> <p>1.4. Akreditacija programa za studiranje na daljinu i online studijske programe;</p> <p>1.5. Priznavanje validne međunarodne akreditacije, akreditovanih ili priznatih agencija članice ENQAR ili USDE, kroz proces ocenjivanja od strane KAA;</p>
<p style="text-align: center;">Neni 27 E drejta për akreditim</p> <p>1. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë, publike dhe private, që funksionojnë në Kosovë dhe që ofrojnë programe të studimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 27 The right to accreditation</p> <p>1. All higher education institutions, public and private, operating in Kosovo and offering study programs leading to an academic and /</p>	<p style="text-align: center;">Član 27 Pravo na akreditaciju</p> <p>1. Sve institucije visokog obrazovana, javne i privatne, koje deluju na Kosovu i nude studijske programe koji vode do sticanje</p>

<p>që shpijnë tek marrja e një diplome akademike dhe-apo profesionale, mund të jenë kandidatë për akreditim.</p> <p>2. Institucioni i akredituar i arsimit të lartë i nënshtrohet riakreditimit në baza periodike në përputhje me kohëzgjatjen e përcaktuar në vendimin e AKA-së.</p> <p>3. Nivelet e programeve të studimit për të cilat kërkohet akreditim janë të përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.</p> <p>4. Akreditimi i institucioneve dhe i programeve të shkencave të aplikuara dhe profesionale:</p> <p>4.1. Programet profesionale, programet e shkencave të aplikuara, programet e sigurisë dhe mbrojtjes dhe programet e ashtuquajtura të shkurta në nivelet post-sekondare të përlllogaritura me ECTS kredi, mund të ofrohen nga institucionet e shkencave të aplikuara, institucionet arsimore të sigurisë dhe mbrojtjes dhe të IAL;</p> <p>4.2. Institucionet e Shkencave të Aplikuara mund të ofrojnë edhe diploma akademike, siç përcaktohet me këtë ligj;</p>	<p>or professional degree may be candidates for accreditation.</p> <p>2. The accredited institution of higher education is subject to re-accreditation on a periodic basis in accordance with the duration set out in the decision of the KAA.</p> <p>3. The levels of study programs for which accreditation is required are defined by the Law on Higher Education and the National Qualifications Framework.</p> <p>4. Accreditation of institutions and programs of applied and professional sciences:</p> <p>4.1. Professional programmes, applied science programmes, security and defence programmes and so-called short programs at post-secondary levels estimated with ECTS loans can be offered by applied scienceinstitutions, security and defence educational institutions and HEIs;</p> <p>4.2. Institutions of Applied Sciences may also offer academic degrees, as defined by this law;</p>	<p>akademske i- ili profesionalne diplome mogu biti kandidati za akreditaciju.</p> <p>2. Akreditovane institucije visokog obrazovanja podležu periodičnoj re/akreditaciji u skladu sa vremensko trajanje navedeno u odluci KAA.</p> <p>3. Nivoi studijskih programa za koje je se zahteva akreditacija utvrđeni su Zakonom o visokom obrazovanju i Nacionalnom okviru za kvalifikacije.</p> <p>4. Akreditacija institucija i programa primenjenih i profesionalnih nauka:</p> <p>4.1. Profesionalni programi, programi primenjenih nauka, programi za bezbednost i i zaštitu i takozvane kratke programe na post-sekondarnom nivoima obračunatim sa ECTS kreditima, mogu ponuditi institucije primenjenih nauka, obrazovne institucije za bezbednost i zaštitu i IVO-a;</p> <p>4.2. Institucije primenjenih nauka mogu da nude akademske za razvoj diplome, kako što je definisano ovim zakonom;</p>
---	--	--

<p>4.3. Përmbajtja e programit (kurrikula) në shkollat e larta profesionale dhe në institucionet e shkencave të aplikuara duhet të shpie në arritjen e një kualifikimi të diplomës profesionale të nivelit 5 ose 6 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve;</p> <p>4.4. Kualifikimet profesionale dhe ato të shkencave të aplikuara duhet të mbështeten nga një fushë e industrisë, e cila do të vërtetojë se këto kualifikime janë të dobishme dhe të njohura në atë fushë të caktuar të industrisë;</p> <p>4.5. Kualifikimet duhet të kenë një strukturë e cila reflekton qartë Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe është në pajtueshmëri me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve;</p> <p>4.6. Kriteret shtesë dhe standardet e akreditimit për institucionet e shkencave të aplikuara duke përfshirë institucionet e larta dhe profesionale janë përcaktuar në këtë ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 28 Procedurat, kriteret dhe standardet e akreditimit</p> <p>1. AKA harton politika, rregullore, procedura dhe standarde të akreditimit.</p>	<p>4.3. The content of the program (curriculum) in higher vocational schools and institutions of applied sciences should lead to the achievement of a professional diploma qualification of level 5 or 6 according to the National Qualifications Framework;</p> <p>4.4. Professional and applied science qualifications must be supported by a field of industry, which will prove that these qualifications are useful and recognized in that particular field of industry;</p> <p>4.5. Qualifications must have a structure which clearly reflects the National Qualifications Framework and is in line with the European Qualifications Framework;</p> <p>4.6. Additional criteria and accreditation standards for institutions of applied sciences, including higher and professional institutions, are defined in this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 28 Accreditation procedures, criteria and standards</p> <p>1. KAA drafts accreditation policies, regulations, procedures and standards.</p>	<p>4.3. Sadržaj programa (kurikulum) u višim profesionalnim školama i institucijama primenjenih nauka treba da vodi ka sticanju profesionalne diplome 5 ili 6 nivo prema Nacionalnom okviru kvalifikacija;</p> <p>4.4. Profesionalne kvalifikacije i kvalifikacije primenjenih nauka moraju biti podržane nekoj od industrijskoj oblasti, koja će dokazati da su ove kvalifikacije korisne i priznate u toj određenoj oblasti industrije;</p> <p>4.5. Kvalifikacije bi trebalo da imaju strukturu koja jasno odražava Nacionalni okvir kvalifikacija i da je u skladu sa Evropskim okvirom kvalifikacija;</p> <p>4.6. Dodatni kriterijumi i standardi akreditacije za Institucije primenjenih nauka uključujući više i profesionalne utvrđena su ovim zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 28 Procedure, kriterijumi i standardi akreditacije</p> <p>1. KAA sastavlja politiku, propise, procedure i standarde za akreditaciju</p>
---	--	--

<p>2. Politikat dhe rregulloret përcaktojnë kornizë të kushteve që do të plotësojnë IAL dhe institucionet e shkencave të aplikuara, profesionale për ofrimin e shërbimeve cilësore në arsimin e lartë.</p> <p>3. Procedurat, kriteret dhe standardet e AKA-së, janë të bazuara në Standardet dhe Udhëzuesit Evropian të Sigurimit të Cilësisë dhe në praktikat e mira ndërkombëtare.</p> <p>4. Standardet e akreditimit formulohen në formë të rregullave të cilat përkufizojnë nivelin e kërkuar të cilësisë së shërbimeve që duhet të arrihen nga institucioni i arsimit të lartë.</p> <p>5. Procedurat, kriteret dhe standardet e akreditimit për institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e shkencave të aplikuara, përcaktohen me aktet e brendshme të nxjerra dhe të miratuara nga KSHC.</p> <p>6. Standardet e akreditimit aplikohen në të gjitha proceset e sigurimit të cilësisë, përfshirë vlerësimin e institucionit të arsimit të lartë, programit të studimit, degës si dhe njohjes së akreditimit.</p>	<p>2. Policies and regulations define the framework of conditions that will be met by HEIs and institutions of applied, professional sciences for the provision of quality services in higher education.</p> <p>3. KAA procedures, criteria and standards are based on European Quality Assurance Standards and Guidelines and international good practices.</p> <p>4. Accreditation standards are formulated in the form of rules which define the required level of quality of services to be achieved by the institution of higher education.</p> <p>5. Accreditation procedures, criteria and standards for institutions of higher education and institutions of applied sciences are determined by internal acts issued and approved by the SQC.</p> <p>6. Accreditation standards are applied in all quality assurance processes, including the evaluation of the higher education institution, the study program, the branch and the recognition of accreditation.</p>	<p>2. Politika i propisi definišu okviru uslova koje će ispunjavati IVO i institucije primenjenih, profesionalnih nauka za pružanje kvalitetnih usluga u visokom obrazovanju.</p> <p>3. Procedure, kriterijumi i standardi KAA zasnivaju se na evropskim standardima i evropske smernice za obezbeđivanje kvaliteta i dobrim međunarodnim praksama.</p> <p>4. Standardi akreditacije formulišu se u obliku pravila koja definišu traženi nivo kvaliteta usluga koji treba da postignu institucije visokog obrazovanja.</p> <p>5. Procedure, kriterijumi i standardi akreditacije za Institucija visokog obrazovanja i Institucije primenjenih nauka, utvrđuju se internim aktima donetih i usvojenih od DSK-a.</p> <p>6. Standardi akreditacije primenjuju se u svim procesima obezbeđivanje kvaliteta , uključujući procenu institucije visokog obrazovanja, studijskog programa, grane kao i priznavanje akreditacije.</p>
--	---	--

<p align="center">Neni 29 Fushat e standardeve për akreditim</p>	<p align="center">Article 29 Areas of standards for accreditation</p>	<p align="center">Član 29 Oblasti standarda za akreditaciju</p>
<p>1. Fushat e standardeve për akreditim, riakreditim institucional, përfshijnë:</p> <p>1.1. Misioni i institucionit/ programit të studimit dhe objektivat institucionale, përfshirë planifikimin strategjik, qeverisjen dhe administrimin;</p> <p>1.2. Resurset dhe menaxhimi financiar;</p> <p>1.3. Integriteti akademik, përgjegjshmëria dhe llogaridhënia;</p> <p>1.4. Menaxhimi i cilësisë;</p> <p>1.5. Mësimdhënia dhe mësimnxënia;</p> <p>1.6. Hulumtimi;</p> <p>1.7. Stafit, proceset e punësimit dhe zhvillimit profesional;</p> <p>1.8. Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse;</p> <p>1.9. Mjedisi i të nxënësve, pajisjet dhe burimet;</p> <p>1.10. Bashkëpunimi institucional dhe</p>	<p>1. Areas of standards for institutional accreditation, re-accreditation, include:</p> <p>1.1. Institution mission / study program and institutional objectives, including strategic planning, governance and administration;</p> <p>1.2. Resources and financial management;</p> <p>1.3. Academic integrity, responsibility and accountability;</p> <p>1.4. Quality management;</p> <p>1.5. Teaching and learning;</p> <p>1.6. Research;</p> <p>1.7. Staff, employment processes and professional development;</p> <p>1.8. Student administration and support services;</p> <p>1.9. Learning environment, equipment and resources;</p>	<p>1. Oblasti standarde za institucionalnu akreditaciju, re-akreditaciju, obuhvataju:</p> <p>1.1. Misija institucije /studijskog programa institucionalni ciljevi, uključujući strateško planiranje, upravljanje i administriranje;</p> <p>1.2. Resursi i finansijsko menadžiranje;</p> <p>1.3. Akademska integritet, odgovornost i odgovornost;</p> <p>1.4. Menadžiranje kvaliteta;</p> <p>1.5. Nastava i učenje;</p> <p>1.6. Istraživanje;</p> <p>1.7. Osoblje, procesi zapošljavanja i profesionalni razvoj;</p> <p>1.8. Administracija studenata usluge podrške;</p> <p>1.9. Sredina za učenje, oprema i izvori;</p>

<p>ndërlidhja me tregun e punës;</p> <p>1.11. Ndërkombëtarizimi dhe</p> <p>1.12. Fusha tjera të standardeve të miratuara nga KSHC.</p> <p>2. Fushat e standardeve për akreditimin, riakreditim të programeve të studimit duhet të përfshijnë:</p> <p>2.1. Misioni i programit të studimit, objektivat, administrimi dhe resurset;</p> <p>2.2. Menaxhimi i cilësisë;</p> <p>2.3. Stafi akademik;</p> <p>2.4. Hulumtimi;</p> <p>2.5. Studentët;</p> <p>2.6. Kurrikula dhe planet mësimore;</p> <p>2.7. Mjedisi i të nxënit, pajisjet dhe burimet;</p> <p>2.8. Fusha tjera të standardeve të miratuara nga KSHC.</p>	<p>1.10. Institutional cooperation and liaison with the labor market;</p> <p>1.11. Internationalization and</p> <p>1.12. Other areas of standards approved by the SQC.</p> <p>2. Areas of standards for accreditation, re-accreditation of study programs should include:</p> <p>2.1. Study program mission, objectives, administration and resources;</p> <p>2.2. Quality management;</p> <p>2.3. Academic staff;</p> <p>2.4. Research;</p> <p>2.5. Students;</p> <p>2.6. Curricula and teaching plans;</p> <p>2.7. Learning environment, equipment and resources;</p> <p>2.8. Other areas of standards approved by the SQC.</p>	<p>1.10. Institucionalna saradnja i veza sa tržištem rada.</p> <p>1.11. Internacionalizacija i</p> <p>1.12. Druge oblasti standarda odobrenih od strane DSK</p> <p>2. Oblasti standarda za akreditaciju, re-akreditaciju studijskih program treba da obuhvataju:</p> <p>2.1. Misija programa studiranje, objekviti, administriranje i resursi;</p> <p>2.2. Manadžiranje kvaliteta;</p> <p>2.3. Akademsko osoblje</p> <p>2.4. Istraživanje</p> <p>2.5. Studenti.</p> <p>2.6. Kurikulum i nastavni plan;</p> <p>2.7. Sredina za učenje, opremu i izvore.</p> <p>2.8. Druge oblasti standarda odobrenih od strane DSK</p>
---	---	--

<p>3. Akreditimi i një institucioni të arsimit të lartë dhe, apo të programeve të tij të studimit bazohen në arritjet e nivelit substancial të të gjitha standardeve të përcaktuara nga AKA në akte përkatëse nënligjore dhe administrative.</p> <p>4. AKA, siguron që procesi i hartimit të këtyre procedurave të përfshijë akterët relevantë, në veçanti institucionet e arsimit të lartë dhe studentët.</p> <p>5. AKA duhet të sigurojë që procedurat, kriteret dhe standardet e akreditimit të përkrahin zhvillimin e sigurimit të cilësisë nga IAL-të.</p>	<p>3. Accreditation of a higher education institution and / or its study programs are based on the achievements of the substantial level of all standards set by the KAA in relevant sub-legal and administrative acts.</p> <p>4. KAA ensures that the process of drafting these procedures involves relevant stakeholders, in particular higher education institutions and students.</p> <p>5. KAA should ensure that accreditation procedures, criteria and standards support the development of quality assurance by HEIs.</p>	<p>3. Akreditacija institucije visokog obrazovanja i, ili njene studijske programe zasnivaju se na dostignućima supstancijalnog nivoa svih standarda utvrđenih od KAA u dotičnim pod zakonskim i administrativnim aktima.</p> <p>4. KAA , obezbeđuje da proces izrade ovih procedura da uključuje relevantne aktere, posebno institucije visokog obrazovanja i studente.</p> <p>5. KAA treba da obezbedi da procedure, kriterijume i standarde akreditacije podrže razvoj obezbeđivanje kvaliteta od strane IVO-a.</p>
<p>Neni 30 Afatet kohore dhe mënyra e aplikimit për akreditim</p>	<p>Article 30 Deadlines and application manner for accreditation</p>	<p>Član 30 Vremenski rokovi i način apliciranja za akreditaciju</p>
<p>1. Institucioni i arsimit të lartë aplikon për akreditim, riakreditim, validim institucional apo programor nëpërmes dorëzimit të aplikacionit në AKA deri më 31 korrik të vitit paraprak.</p> <p>2. Me rastin e aplikacioneve për akreditime institucionale, IAL-të duhet të ofrojnë dëshmi nga organet kompetente që themeluesit dhe menaxhmenti i lartë nuk janë</p>	<p>1. The higher education institution applies for accreditation, re-accreditation, institutional or program validation by submitting the application to the KAA by July 31st of the previous year.</p> <p>2. In the case of applications for institutional accreditation, HEIs must provide evidence from the competent authorities that the founders and senior management are not</p>	<p>1. Institucija visokog obrazovanja podnosi zahteva za institucionalnu akreditaciju, re-akreditaciju validaciju ili programa putem dostavljanje aplikacije KAA do 31 jula prethodnog godine.</p> <p>2. U slučaju zahteva za institucionalnu akreditaciju, IVO moraju biti dostavljeni dokaz nadležnih organa da osnivači i više menadžment nisu pod istragom ili osuđeni za krivična dela poslednje pet godine.</p>

<p>nën hetime ose të dënuar për vepra penale në pesë vitet e fundit.</p> <p>3. Afati për dorëzim të kërkesës për akreditim, riakreditim, validim dhe deklarim të personelit akademik është 1 – 31 korrik të secilit vit kalendarik.</p> <p>4. AKA duhet të trajtojë kërkesën e institucionit për akreditim, riakreditim dhe validim dhe t'i kthej përgjigje institucionit brenda një viti nga afati i pranimi të aplikacionit.</p> <p>5. AKA do të trajtoj kërkesën për akreditim,riakreditim,validim sipas afateve të përcaktuara me përjashtim të:</p> <p>5.1. Fatkeqësive natyrore;</p> <p>5.2. Situatave emergjente nacionale dhe ndërkombëtare;</p> <p>5.3. Në rrethana të caktuara, në bazë të vlerësimit të KSHC, AKA mund të administrojë aspekte të procesit të akreditimit edhe në formë elektronike (online).</p> <p>6. AKA zhvillon dhe miraton udhëzuesit dhe procedurat për vlerësim online.</p>	<p>under investigation or convicted of criminal offenses in the last five years.</p> <p>3. The deadline for submitting the application for accreditation, re-accreditation, validation and declaration of academic staff is July 1 - 31 of each calendar year.</p> <p>4. KAA must handle the request of the institution for accreditation, re-accreditation and validation and respond to the institution within one year from the deadline for receipt of the application.</p> <p>3. KAA will handle the request for accreditation, re-accreditation, validation according to the deadlines set with the exception of:</p> <p>5.1. Natural disasters;</p> <p>5.2. National and international emergent situations;</p> <p>5.3. Certain circumstances, based on the evaluation of SQC, KAA can administer aspects of the accreditation process even in electronic form (online).</p> <p>6. KAA develops and adopts guidelines and procedures for online evaluation.</p>	<p>3. Rok za podnošenje zahteva za akreditaciju, re-akreditaciju, validaciju i deklarisanje akademskog osoblja je 1-31. jul svake kalendarske godine.</p> <p>4. KAA mora da razmotri zahtev institucije za akreditaciju, re-akreditaciju i validaciju i da odgovori instituciji u roku od jedne godine nakon prijema aplikacije.</p> <p>5. KAA će pregledati zahtev za akreditaciju / re-akreditaciju / validaciju u skladu sa zadatim rokovima, sa izuzetkom:</p> <p>5.1. Prirodne nepogode;</p> <p>5.2. Vanredne situacije na nacionalnom i međunarodnom nivou;</p> <p>5.3. U određenim okolnostima, na osnovu procene DSK, KAA može vršiti administriranje procesa akreditacije i u elektronskom obliku (online).</p> <p>6. AKA razvija i odobrava smernice i procedure za online procenu.</p>
--	--	---

<p>7. Formati i aplikacionit për akreditim, dokumentacioni dhe procedurat duhet të jenë sipas kërkesave të AKA-së të përcaktuara në Manualin e Akreditimit.</p> <p>8. Institucioni i arsimit të lartë nuk ka të drejtë të tërhiqet nga procesi i akreditimit pas aplikimit. Në rast të tërheqjes ose refuzimit për t'iu nënshtruar procesit të akreditimit pas aplikimit do të konsiderohet se aplikimi për akreditim është refuzuar.</p>	<p>7. Application format for accreditation, documentation and procedures should be according to the KAA requests, set out in the Accreditation Manual.</p> <p>8. Higher education institution has no right to withdraw from the accreditation process after application. In case of withdrawal or refusal to undergo the accreditation process after application, it will be considered that the application for accreditation has been rejected.</p>	<p>7. Format aplikacije za akreditaciju, dokumentacije i procedure mora da bude u skladu sa zahtevima KAA navedenim u Priručniku za akreditaciju.</p> <p>8. Institucija visokog obrazovanja nema pravo na povlačenje iz proces akreditacije nakon podnošenje zahteva. U slučaju povlačenja ili odbijanja da podlegne procesu akreditacije nakon podnošenje zahteva smatraće se da je zahtev za akreditaciju odbijen.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 31 Vlerësimi i brendshëm</p>	<p style="text-align: center;">Article 31 Internal evaluation</p>	<p style="text-align: center;">Član 31 Interno ocenjivanje</p>
<p>1. Para zbatimit të vlerësimit të jashtëm, në kuadër të procesit të akreditimit dhe riakreditimit, IAL-të janë të obliguara të organizojnë një proces të konsultimeve të brendshme dhe të hartojnë një raport të vetëvlerësimit.</p> <p>2. Gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm IAL siguron gjithëpërfshirje të të gjitha strukturave dhe akterëve relevantë.</p> <p>3. Raporti i vetëvlerësimit dorëzohet në AKA një 1 javë (5 ditë pune) pas marrjes së njoftimit për praninë të aplikacionit.</p>	<p>1. Prior to the implementation of the external evaluation, within the accreditation and re-accreditation process, HEIs are obliged to organize an internal consultation process and draft a self-evaluation report.</p> <p>2. During the internal evaluation process, the HEI ensures the inclusion of all structures and relevant stakeholders.</p> <p>3. The self-assessment report is submitted to KAA 1 week (5 working days) after receiving the notification for acceptance of the application.</p>	<p>1. Pre sprovođenja eksterne evaluacije, u okviru procesa akreditacije i re/akreditacije, IVO su dužne da organizuju proces internih konsultacija i da sastave nacrt izveštaja o samoocenjivanju.</p> <p>2. Tokom procesa interne evaluacije, IVO obezbeđuje uključivanje svih relevantnih struktura i aktera.</p> <p>3. Izveštaj o samoocenjivanju podnosi se KAA 1 nedelje (5 radna dana) nakon dobijanja obaveštenja o prijemu zahteva.</p>

<p>4. Raporti i vetëvlerësimit hartohet në bazë të akteve të brendshme dhe Manualin e Akreditimit të AKA.</p> <p style="text-align: center;">Neni 32 Vlerësimi i jashtëm</p> <p>1. AKA organizon procesin e akreditimit për institucionet e arsimit të lartë në bazën e një vlerësimi të jashtëm, i cili realizohet nga ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në përbërje prej:</p> <p>1.1. Dy (2) vlerësues deri në shtatë (7) vlerësues të jashtëm, varësisht nga numri i programeve të studimit që vlerësohen;</p> <p>1.2. Së paku një student.</p> <p>2. Vlerësimi i jashtëm nuk mund të realizohet pa shqyrtimin e një raporti të vetëvlerësimit të hartuar nga institucioni nën vlerësim sipas formatit të kërkuar nga AKA.</p> <p>3. Realizimi i vlerësimit të jashtëm nënkupton organizimin e një vizite me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.</p>	<p>4. The self-assessment report is drafted based on internal acts and the KAA Accreditation Manual.</p> <p style="text-align: center;">Article 32 External evaluation</p> <p>1. KAA organizes the accreditation process for higher education institutions on the basis of an external evaluation, which is carried out by international accreditation experts consisting of:</p> <p>1.1. Two (2) evaluators up to seven (7) external evaluators, depending on the number of study programs being evaluated.</p> <p>1.2. At least one student.</p> <p>2. External evaluation cannot be performed without reviewing a self-evaluation report prepared by the institution under evaluation according to the format required by KAA.</p> <p>3. Carrying out external evaluation means organizing a visit with international accreditation experts.</p>	<p>4. Izveštaj o samoocenjivanju sastavlja se na osnovu sa unutrašnjih akata i Priručnik za akreditaciju KAA.</p> <p style="text-align: center;">Član 32 Eksterno ocenjivanje</p> <p>1. KAA organizuje proces akreditacije za institucije visokog obrazovanja na osnovu eksterne procene, koju sprovode međunarodni eksperti za akreditaciju sastavljen od:</p> <p>1.1. Dva (2) ocenjivača do sedam (7) međunarodna ocenjivača, u zavisnosti od broj studijskih programa koji se ocenjuju</p> <p>1.2. Najmanje jedna student.</p> <p>2. Eksterno ocenjivanje se ne može izvršiti bez preispitivanja izveštaja o Samoocenjivanju sastavljenim od strane institucije koja se bavi procenom u skladu sa formatom koji zahteva KAA.</p> <p>3. Realizacija eksternog ocenjivanja znači organizovanje poseta sa međunarodnim ekspertima za akreditaciju.</p>
---	---	--

<p>4. Vizita e akreditimit strukturohet në atë mënyrë që të përmbushen kërkesat e procesit të akreditimit.</p> <p>5. Rezultati i vizitës duhet të jetë hartimi i një raporti të jashtëm të vlerësimit nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit, në bazë të kriterëve dhe standardeve të përcaktuara të AKA-së, i cili duhet të konstatoj nëse institucioni nën vlerësim përmbush standardet e akreditimit.</p> <p>6. Raporti i vlerësimit të jashtëm përmban rekomandimin për akreditim ose refuzim të akreditimit.</p> <p>7. Raporti i vlerësimit të jashtëm përmban numrin e studentëve për vit akademik dhe kohëzgjatjen e akreditimit.</p>	<p>4. The accreditation visit is structured in such a way as to meet the requirements of the accreditation process.</p> <p>5. The result of the visit should be the drafting of an external evaluation report by international accreditation experts, based on the criteria and standards set by the KAA, which should ascertain whether the institution under evaluation meets the accreditation standards.</p> <p>6. The external evaluation report contains the recommendation for accreditation or refusal of accreditation.</p> <p>7. The external evaluation report contains the number of students per academic year and the duration of accreditation.</p>	<p>4. Poseta akreditacije strukturirana je tako da ispunjava zahteve procesa akreditacije.</p> <p>5. Rezultat posete treba da bude izrada izveštaja eksternog ocenjivanja od strane međunarodnih eksperata za akreditaciju, na osnovu kriterijumima i standardima koje je utvrdila KAA, a koja treba da utvrdi da li institucija koja se ocenjuje ispunjava standarde akreditacije.</p> <p>6. Izveštaj eksterne evaluacije sadrži preporuku za akreditaciju ili odbijanje akreditacije.</p> <p>7. Izveštaj eksterne evaluacije sadrži broj studenata za akademsku godinu i vreme trajanja akreditacije</p>
<p>Neni 33 Vlerësuesit e jashtëm</p>	<p>Article 33 External evaluators</p>	<p>Član 33 Eksterni ocenjivači</p>
<p>1. Detyrat e vlerësuesve të jashtëm janë:</p> <p>1.1. Shqyrtimi i dokumenteve të dorëzuara nga institucioni para vizitës në institucion;</p> <p>1.2. Realizimi i vizitës në institucionin e arsimit të lartë të aranzhuar nga AKA;</p>	<p>1. The tasks of external evaluators are:</p> <p>1.1. Review of documents submitted by the institution before the visit to the institution;</p> <p>1.2. Carrying out the visit to the higher education institution arranged by KAA;</p>	<p>1. Zadaci eksternih ocenjivača su:</p> <p>1.1. Pregled dokumenata koje je podnela institucija pre posete instituciji;</p> <p>1.2. Realizacija posete instituciji visokog obrazovanja angazovanu od strane KAA;</p>

<p>1.3. Hartimi i draftraportit të vlerësimit pas vizitës së realizuar në terren;</p> <p>1.4. Shqyrtimi i komenteve të dorëzuara nga institucioni për gjendjen faktike të draftraportit;</p> <p>1.5. Finalizimi i raportit të vlerësimit të jashtëm për institucionin e arsimit të lartë;</p> <p>1.6. Raporti final duhet të përmbajë një rekomandim për numrin e studentëve të cilët mund të regjistrohen për një vit akademik në programin përkatës dhe kohëzgjatjen e akreditimit;</p> <p>1.7. Dorëzimi i raportit të vlerësimit të jashtëm në AKA.</p>	<p>1.3. Drafting the evaluation report after the field visit;</p> <p>1.4. Review of comments submitted by the institution on the factual situation of the draft report;</p> <p>1.5. Finalization of the external evaluation report for the higher education institution;</p> <p>1.6. The final report should contain a recommendation on the number of students who can enroll for one academic year in the relevant program and the duration of accreditation;</p> <p>1.7. Submission of the external evaluation report to the KAA.</p>	<p>1.3. Izrada nacрта izveštaja o proceni nakon obavljene posete na terenu;</p> <p>1.4. Razmatranje komentara koje je dostavila institucija za činjenično stanje nacрта izveštaja;</p> <p>1.5. Finalizacija izveštaja o eksternoj evaluaciji za instituciju visokog obrazovanja;</p> <p>1.6. Konačni izveštaj treba da sadrži preporuku o broju studenata koji se mogu upisati za jednu akademsku godinu u određeni program i vremensko trajanje akreditacije;</p> <p>1.7. Podnošenje izveštaja o spoljnoj evaluaciji KAA.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 34 Vendimi për akreditim</p> <p>1. KSHC vlerëson raportin e vlerësimit të jashtëm dhe merr vendim përkitazi me rekomandimin e dhënë në raport.</p> <p>2. KSHC me rastin e vendimit për akreditim, riakreditim, apo validim, vendos për kushtet dhe kohëzgjatjen e akreditimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 34 Decision for accreditation</p> <p>1. The SQC evaluates the external evaluation report and makes a decision regarding the recommendation given in the report.</p> <p>2. Upon decision on accreditation, re-accreditation or validation, the SQC decides on the conditions and duration of accreditation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 34 Odluka o akreditaciji</p> <p>1. DSK procenjuje izveštaj o eksternoj proceni i donosi odluku u vezi sa preporuke koja je data u izveštaju.</p> <p>2. DSK prilikom odluke o akreditaciji, re-akreditaciji ili validaciji , odlučuje o uslovima i vremenskom trajanju te akreditacije</p>

<p>3. Vendimi për akreditim dhe riakreditim përcakton:</p> <p>3.1. Programet e akredituara;</p> <p>3.2. Vlefshmërinë e akreditimit;</p> <p>3.3. Emërtimin e programit;</p> <p>3.4. Emërtimin e gradës së studimeve;</p> <p>3.5. Numrin e kredive të fituara (ECTS);</p> <p>3.6. Numrin e studentëve që regjistrohen për një vit akademik;</p> <p>3.7. Bartësit e programeve dhe nivelin e studimeve.</p> <p>4. Transferi i studentëve mund të bëhet brenda kuotës së lejuar të studentëve në vendimin për akreditim të programit.</p> <p>5. Transferi i studentëve mund të bëhet vetëm në programe të cilat kanë ngjashmëri në përmbajtje së paku 70%.</p> <p>6. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.</p>	<p>3. The decision on accreditation, re-accreditation determines:</p> <p>3.1. Accredited programs;</p> <p>3.2. Validity of accreditation;</p> <p>3.3. Program naming;</p> <p>3.4. Naming the study degree;</p> <p>3.5. Number of credits earned (ECTS);</p> <p>3.6. Number of students enrolled for one academic year;</p> <p>3.7. Programs providers and level of studies;</p> <p>4. The transfer of students can be done within the allowed quota of students in the decision for accreditation of the program.</p> <p>5. The transfer of students can only be done in programs that have similarities in content of at least 70%.</p> <p>6. The defined number of students is applied for all years of study for the accreditation period.</p>	<p>3. Odluka o akreditaciji re-akreditaciji određuje:</p> <p>3.1. Akreditovane programe;</p> <p>3.2. Valjanost akreditacije;</p> <p>3.3. Naziv programa;</p> <p>3.4. Naziv stepen studije;</p> <p>3.5. Broj stečenih kredita (ECTS);</p> <p>3.6. Broj studenata koji se upisuju u toku jedne akademske godine;</p> <p>3.7. Nosilac programa i nivo studije;</p> <p>4. Transfer studenata se može izvršiti u okviru dozvoljene kvote studenata u odluci za akreditaciju programa.</p> <p>5. Transfer studenata se može izvršiti samo u programima koji imaju sličnost u sadržaju najmanje 70 %</p> <p>6. Broj utvrđen novih studenata primenjuje se za sve godine studija za navedeni period akreditacije.</p>
--	---	---

<p>7. AKA njofton Ministrinë me shkrim dhe përcjell të gjitha kopjet e vendimeve për akreditim/riakreditim dhe validim.</p> <p>8. Në rast se një institucion nuk arrin të riakreditohet në nivel institucional, kjo do të rezultojë me organizimin e një procesi tjetër të riakreditimit pas një viti.</p> <p>9. Nëse institucioni i arsimit të lartë dështon të riakreditohet në nivel institucional për herë të dytë të njëpasnjëshëm, AKA do të njoftoj Ministrinë për procedura të mëtejme.</p> <p>10. Institucionit i cili dështon herën e parë të marrë riakreditim institucional, i ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për vitin akademik përkatës, ndërsa i lejohe të vazhdojë me studentët aktualë të regjistruar deri në vlerësimin e dytë të përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni.</p> <p>11. Institucioni i cili edhe pas vlerësimit të dytë nuk merr akreditim institucional, obligohet që të sigurojë transferin e studentëve në institucionet me të cilat ka marrëveshje për transferin e studentëve me rastin e mbylljes.</p> <p>12. IAL i cili dështon në procesin e akreditimit, obligohet që t'i pajisë studentët</p>	<p>7. KAA notifies the Ministry in writing and forwards all copies of decisions for accreditation / re-accreditation and validation.</p> <p>8. If an institution fails to be re-accredited at the institutional level, this will result in organizing another re-accreditation process after one year.</p> <p>9. If the higher education institution fails to be re-accredited at the institutional level for the second time in a row, the KAA will notify the Ministry of further procedures.</p> <p>10. The institution that fails for the first time to obtain institutional re-accreditation, is prohibited from enrolling new students for the respective academic year, while it is allowed to continue with the current enrolled students until the second evaluation defined in paragraph 6 of this article.</p> <p>11. The institution which even after the second evaluation does not receive institutional accreditation, is obliged to ensure the transfer of students to institutions with which there is an agreement for the transfer of students upon closure.</p> <p>12. HEI which fails in the accreditation process, is obliged to equip students and the</p>	<p>7. KAA pismeno obaveštava Ministar i prosleđuje sve kopije odluka za akreditaciju / re i akreditaciju, validnost.</p> <p>8. U slučaju da institucija ne uspe da se re/akredituje na institucionalnom nivou, to će rezultirati organizovanjem drugog procesa re-akreditacije nakon jedne godine.</p> <p>9. Ako institucija visokog obrazovanja ne uspe po drugi put da se re-akredituje na institucionalnom nivou uzastopne, KAA će obavestiti Ministarstvo o daljim procedurama.</p> <p>10. Instituciji koja prvi put ne uspe da dobije institucionalnu re-akreditaciju , zabranjeno je upisivanje novih studenata za relevantnu akademsku godinu, dok dozvoljava se da nastavi sa trenutno upisanim studentima do drugogo ocenjivanje iz stava 6. ovog člana.</p> <p>11. Institucija koja ni nakon drugog procenjivanja ne dobije institucionalnu akreditaciju, dužna je da obezbedi transfer studenata u institucije sa kojom ima sporazum o transfer studenata u slučaju zatvaranja.</p> <p>12. IVO koja ne uspe u procesu akreditacije je , dužna da opremi studente i instituciju</p>
---	---	---

<p>dhe institucionin pranues të studentëve të transferuar me të gjithë dokumentacionin përkatës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 35 Kohëzgjatja e akreditimit</p> <p>1. Kohëzgjatja e akreditimit institucional është tre (3) vjet. Kohëzgjatja e riakreditimit institucional është tre (3) ose pesë (5) vjet.</p> <p>2. Kohëzgjatja e akreditimit të programit është 3 vjet. Kohëzgjatja e riakreditimit të programit është tre (3) ose pesë (5) vjet.</p>	<p>accepting institution of the transferred students with all the relevant documentation.</p> <p style="text-align: center;">Article 35 Duration of accreditation</p> <p>1. The duration of institutional accreditation is three (3) years. The duration of institutional accreditation is three (3) or five (5) years.</p> <p>2. The duration of the program accreditation is 3 years. The duration of program re-accreditation is three (3) or five (5) years.</p>	<p>koja prima transferisane studente sa svom relevantnom dokumentacijom.</p> <p style="text-align: center;">Član 35 Vreme trajanja akreditacije</p> <p>1. Trajanje institucionalne akreditacije je tri (3) godine. Trajanje institucionalne reakreditacije je tri (3) ili pet (5) godine.</p> <p>2. Trajanje akreditacije programa je 3 godine. Trajanje re-akreditacije programa je tri (3) ili pet (5) godine.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 36 Shpenzimet e procesit të akreditimit riakreditimit dhe validimit</p> <p>1. Institucioni i arsimit të lartë bartë koston për procesin e akreditimit dhe riakreditimit institucional të programeve të studimit, të degës dhe të validimit të akreditimit.</p> <p>2. Pagesat e KSHC, KA dhe tarifat për ekspertizë vendore dhe ndërkombëtare përcaktohen me një akt nënligjor të propozuar nga MASHTI dhe të miratuar nga Qeveria.</p>	<p style="text-align: center;">Article 36 Costs of the accreditation, re-accreditation and validation process</p> <p>1. The higher education institution bears the cost for the process of accreditation and institutional re-accreditation of study programs, branch and accreditation validation.</p> <p>2. The SQC, AC payments and fees for local and international expertise are determined by a sub-legal act proposed by MESTI and approved by the Government.</p>	<p style="text-align: center;">Član 36 Troškovi procesa akreditacije re-akreditacije i validaci</p> <p>1. Institucija visokog obrazovanja snosi troškove procesa institucionalne akreditacije i re-akreditacije studijskih programa, smera i validacija akreditacije.</p> <p>2. Uplata DSK, KA i tarife za domaću i međunarodnu ekspertizu se određuju podzakonskim aktom koji predlaže MONTI i usvaja Vlada.</p>

<p align="center">Neni 37 Obligimet e institucioneve të arsimit të lartë pas akreditimit</p>	<p align="center">Article 37 Obligations of higher education institutions after accreditation</p>	<p align="center">Član 37 Obaveze Institucija visokog obrazovanja nakon akreditacije</p>
